



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 shtator 2011
Nr. ref.: RK137/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI36/11

Parashtrues

Arjeta Halimi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mos-përmbarimit të pretenduar të
Aktgjykimit CN. nr. 24/09, të 17 nëntorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në
Gjilan dhe shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut të parashtruesit të
kërkesës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Arjeta Halimi me vendbanim në fshatin Dobresh, Komuna e Vitisë. Ajo tani është 19 vjeçare. Në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) parashtruesja e kërkesës përfaqësohet nga Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional ("CLARD") me seli në Prishtinë.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë të mos-përmbarimit të Aktgjykimit CN. Nr. 24/09, të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit të 17 nëntorit 2009. Me atë aktgjykim padia e parashtrueses së kërkesës ishte miratuar dhe i padituri, pra Drejtoria Komunale për Arsim e Vitisë, ishte obliguar “t’ia njohë paditësit [pra parashtrueses së kërkesës] të gjitha të drejtat që burojnë nga statusi i nxënëses së rregullt në Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës” në Viti”.
Përmes kërkesës së saj, parashtruesja e kërkesës kërkon të sigurojë që aktgjykimin e lartcekur, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Gjilan, do ta përmbarojë Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti. Parashtruesja e kërkesës pretendon se mos-përmbarimi i Aktgjykimit CN. nr. 24/09, të 17 nëntorit 2009 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, asaj ia mohon të drejtën e arsimimit e cila garantohet me të gjitha aktet vendore dhe ndërkombëtare.
3. Parashtruesja e kërkesës pretendon se janë shkelur këto nene të Kushtetutës: neni 24 (Barazia para Ligjit), neni 38 (Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë) dhe neni 47 (E Drejta për Arsimin).
4. Parashtruesja, po ashtu pretendon se në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) janë shkelur të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht: neni 2 i Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (E Drejta në Arsim), neni 9 (Liria e Mendimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë) në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) i po të njëjtës Konventë.
5. Parashtruesja më tej konsideron se ka pasur shkelje të nenit 18 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe nenit 2 dhe 26 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Në fund, në lidhje me instrumentet ndërkombëtare, parashtruesja gjithashtu i referohet nenit 14 dhe 28 të Konventës së KB për të Drejtat e Fëmijëve.
6. Parashtruesja, po ashtu pretendon se në rastin e saj janë shkelur nenet 2, 4 dhe 9 të Ligjit të Kosovës Kundër Diskriminimit (2004/3) si dhe neni 12 i Ligjit për Konfliktet Administrative (03/L-202).

Baza juridike

7. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenet 20 dhe 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregulli 36 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 10 mars 2011 parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
9. Më 21 mars 2011, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare Raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Prof. Dr. Ivan Čukalović dhe Prof. Dr. Enver Hasani.
10. Më 28 prill 2011, Gjykata e njoftoi Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe Kulturës (“DKA”) të Komunës së Vitisë për kërkesën dhe bazuar në nenin 22.2 të Ligjit ftoi DKA që të parashtrojë përgjigjen në kërkesë.

11. Po të njëjtën ditë Gjykata ka njoftuar Gjykatën e Qarkut të Gjiçanit dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për ngritjen e kërkesës.
12. Më 4 maj 2011, Gjykata e Qarkut të Gjiçanit dërgoi përgjigjen në kërkesë.
13. Më 16 maj 2011, DKA dërgoi përgjigjen në kërkesë.
14. MASHT-i nuk ka dërguar përgjigje.
15. Më 28 qershor 2011, Gjykata kërkoi nga Gjykata Komunale e Vitisë që të informohet nëse parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar propozim për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë CN. Nr. 24/09, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut.
16. Më 5 korrik 2011, Gjykata Komunale e Vitisë e dërgoi përgjigjen.
17. Pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.
18. Gjykata në përbërje të plotë mbajti këshillime dhe votoi për kërkesën më 8 korrik 2011 dhe më 23 shtator 2011.

Faktet e rastit

19. Para 15 janarit 2009, parashtruesja ka vijuar mësimin në shkollën e mesme publike “Kuvendi i Lezhës” në Komunën e Vitisë.
20. Parashtruesja filloi bartjen e shamisë në shkollë gjatë gjysmëvjetorit të parë të klasës së 10-të.
21. Parashtruesja pretendon se ajo është njoftuar gojarisht nga drejtorja e shkollës se ajo nuk do të lejohet të vijojë shkollimin përveç nëse do të hiqte shaminë. Ajo pretendon se shkolla ka njoftuar DKA-në që pretendohet t'i ketë bërë të njohur shkollës së bartja e shamisë në shkollë paraqet shkelje të aktit nënligjor që ka të bëjë me uniformën në shkollë.
22. Parashtruesja, po ashtu pretendon se zyrtarë të caktuar në DKA kanë ushtruar trysni mbi të duke kërkuar nga ajo që të nënshkruajë një deklaratë që tregon se ajo pranon të heqë mbulesën.
23. Parashtruesja më tej pretendon se që nga refuzimi i saj për të nënshkruar deklaratën e lartpërmendur asaj iu kërkuar që të mos kthehej më në shkollë.
24. Sipas parashtrueses, nga 15 janari 2009 ajo nuk vijoi më shkollën e mesme publike “Kuvendi i Lezhës” në Viti.
25. Prindërit e parashtrueses, duke vepruar si “përfaqësues të saj ligjorë”, pasi që ajo ishte e mitur, më 6 prill 2009 morën këshillim nga CLARD.
26. Më 15 prill 2009, parashtruesja kërkoi që Drejtorja Komunale e Arsimit në Viti t'i paraqesë njoftimin zyrtar lidhur me statusin e parashtruesit dhe për arsyet e përjashtimit të saj nga shkolla.
27. Më 28 prill të vitit 2009, DKA i është përgjigjur me shkrim parashtrueses siç vijon:

“ I. Informoheni se drejtoria e Shkollës së mesme “Kuvendi i Lezhës” në Viti nuk i ka mohuar dhe nuk i ka parandaluar Arjeta Halimit, nxënëse në klasën e 10-të në këtë shkollë, të drejtën në shkollim. Drejtoria e shkollës kësaj nxënëseje i ka shqiptuar vërejtje gojore lidhur me bartjen e mbulesës dhe kësaj nxënëse i ka sugjeruar që të mos bartë mbulesën në shkollë përndryshe do t'i ndalohej qasja në shkollë.

II. Kjo nxënëse u tërhoq nga procesi mësimor pa iu kërkuar një gjë e tillë dhe ajo nuk ka kërkuar asnjë komunikim ose parashtruar ndonjë kërkesë drejtorisë së shkollës a DKA-së, por DKA-së i është kërkuar që asaj t'i mundësohet e drejta e hyrjes në provimet e vitit të fundit, andaj, e drejta e saj për arsimim nuk është shkelur në asnjë mënyrë.

III. Sipas Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Arsimi i Mesëm nuk është i detyrueshëm por fakultativ, dhe neni 22, pika d e Rregullores Nr. 01-013/86 të Kodit të Mirësjelljes dhe Disiplinës përcakton se nxënësi duhet të veshë të njëjtën uniformë dhe kjo nxënëse ka shkelur këtë Rregullore dhe rregullat e shkollës. Kjo shkollë ka nxënës të besimeve dhe religjioneve të ndryshme dhe nëse një veshje e tillë do të lejohej, atëherë do të dëmtohej procesi arsimor në shkollën tonë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, po ashtu e përcakton Kosovën si shtet laik sa i përket besimeve fetare.”

28. Më 6 maj 2009, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur një ankesë në Departamentin për Inspektorat Arsimor në Gjilan me pretendimin e shkeljes së, *ndër të tjera*, Kushtetutës dhe ligjit të zbatueshëm. Parashtruesja kërkoj që DKA-ja e Vitisë të obligohet ta lejojë të vijojë shkollimin në shkollën “Kuvendi i Lezhës” dhe t’u shqiptohen dënime personave të caktuar brenda DKA-së së Vitisë për shkeljen e Ligjit Kundër Diskriminimit.
29. Inspektorati Regjional për Arsim në Gjilan i është përgjigjur ankesës më 28 gusht 2009, duke thënë se pretendimet e parashtrueses për shkeljen e ligjit në rastin e saj ishin të pabaza dhe të bazuara në interpretimin e gabueshëm të ligjit.
30. Më 18 shtator 2009, parashtruesja e kërkesës ka ushtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës padi për konflikt administrativ. Parashtruesja kërkoj nga Gjykata Supreme të veprohet dhe të shikojë substancën e pohimeve të paditësit dhe të vendosë për ligjshmërinë dhe përputhshmërinë në veprimet e ndërmarra nga Komuna e Vitisë. Parashtruesja kërkoj nga Gjykata Supreme që të anulojë të gjitha veprimet e Komunës së Vitisë me të cilat janë shkelur të drejtat e saj.
31. Më 19 tetor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës deklaroi se nuk kishte juridiksion në kuptim të objektit të çështjes për të gjykuar në rastin e parashtrueses. Gjykata iu referua nenit 9 të Ligjit të atëhershëm të zbatueshëm për konfliktet administrative.
32. Sipas vendimit të Gjykatës Supreme, rasti i parashtrueses kishte të bënte me mbrojtjen nga veprimi i paligjshëm. Andaj, Gjykata Supreme vendosi që tërë dosjen e lëndës ta përcjellë tek Gjykata e Qarkut në Gjilan si gjykatë që kishte juridiksionin e duhur bazuar në Ligjin atëherë të zbatueshëm për gjykatat e rregullta.
33. Më 17 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan nxori Aktgjykimin CN. Nr. 24/09, me të cilin e miratoi padinë e parashtrueses së kërkesës dhe e obligoi Departamentin Komunal të Arsimit të Vitisë që “t’ia pranojë paditëses [pra parashtrueses së kërkesës] të gjitha të drejtat që burojnë nga statusi i nxënësit të rregullt në Gjimnazin ‘Kuvendi i Lezhës’ në Viti.”

34. Gjykata e Qarkut gjeti se "...e paditura [Komuna e Vitisë] përmes veprimit të kundërligjshëm, bazuar në arsyetim gojor, ka larguar nga shkolla paditësen [parashtruesen e kërkesës] sepse ajo kishte bartur shami. Deklarimet e të paditurës se çështja e bartjes së uniformës është e rregulluar në mënyrë specifike... janë kontradiktore."
35. Më 23 nëntor 2009, parashtruesja e kërkesës e informoi Departamentin Komunal të Arsimit në Viti për Aktgjykimin CN. nr. 24/09, të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, dhe kërkoi që aktgjykimi të zbatohet.
36. Më 25 janar 2010, parashtruesja e kërkesës i shkroi Gjykatës së Qarkut në Gjilan për ta informuar gjykatën se Aktgjykimi Cn. Nr. 24/09, akoma nuk është zbatuar nga ana e DKA-së së Vitisë dhe për të kërkuar që gjykata të marrë masa brenda juridiksionit të saj për zbatimin e aktgjykimit.
37. Deri më sot, parashtruesja e kërkesës nuk ka kërkuar nga Gjykata Komunale në Viti që të përmbarojë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan Cn. Nr. 24/09, të 17 nëntorit 2009.

Komentet e palës kundërshtare dhe/apo të palëve të interesuara

38. Gjykata e Qarkut në Gjilan në përgjigjen e vet të dorëzuar Gjykatës Kushtetuese më 4 maj 2011 theksoi se, nuk është më në kompetencën e saj të veprojë në lidhje me këtë çështje, pasi që ajo tashmë kishte vendosur për të dhe se, gjykata kompetente për përmbarimin e aktgjykimit ishte Gjykata Komunale në Viti.
39. DKA në përgjigjen e vet të 16 majit 2011, dërguar Gjykatës Kushtetuese, e kundërshtoi thelbin e ankesës së parashtrueses dhe theksoi se pohimet e parashtrueses së kërkesës nuk qëndrojnë dhe se ankesa e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese ishte e pabazuar dhe pa argumente.
40. Gjykata Komunale në Viti në përgjigjen e vet të 5 korrikut 2011, konfirmoi se parashtruesja e kërkesës kurrë nuk kishte paraqitur propozim për përmbarimin e Aktgjykimit të formës së prerë CN. Nr. 24/09 të Gjykatës së Qarkut.

Argumentet e paraqitura nga palët

41. Parashtruesja e kërkesës thekson se asaj i është mohuar e drejta për të vazhduar shkollimin e saj. Sipas saj, pavarësisht se në Kosovë njihen të drejtat e saj për shkollim, që dy vjet asaj nuk i është lejuar të vijoje shkollën. Siç u theksua më herët, parashtruesja pohon se janë shkelur nenet e Kushtetutës si në vazhdim: neni 24 (Barazia para ligjit), neni 38 (Liria e Besimit, Ndërgjegjes dhe Fesë) dhe neni 47 (E drejta për shkollim).
42. Në këtë kuptim, parashtruesja e kërkesës theksoi se "nenet e lartpërmendura janë shkelur, meqë asaj i është mohuar e drejta për të vazhduar shkollimin e saj në përputhje me aftësitë e saj, sepse institucioni publik ia ka mohuar asaj të drejtën për të ndjekur procesin e mësimi përderisa ajo bart shaminë islame, ndonëse ky akt konsiderohet nga Kushtetuta si diskriminim në baza fetare."
43. Në fund, parashtruesja e kërkesës pohon se DKA në Viti ka dështuar në implementimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, ndonëse aktgjykimi është i obligueshëm dhe si rrjedhojë ende po vazhdonte mohimi i të drejtës së saj për të vazhduar shkollimin. Ajo argumenton se nuk ka mjet tjetër juridik që mund ta shfrytëzojë për të siguruar përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

44. Gjykata e Qarkut, në thelb kundërshton pranueshmërinë e kërkesës, duke pohuar se parashtruesja e kërkesës duhet të shterë të gjitha mjetet e disponueshme, pra, të kërkojë përmbarimin e aktgjykimit në Gjykatën Komunale në Viti.
45. DKA argumenton se kërkesa e parashtrueses e dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese është e pabazuar dhe pa argumente. Përmes këtij argumenti, DKA në thelb pohon se kërkesa e parashtrueses është qartazi e pabazuar.
46. Në mbështetje të argumenteve të veta, DKA, në përgjigjen dërguar Gjykatës Kushtetuese thekson se: “Ne dëshirojmë t’ju informojmë se askush nga drejtoria e shkollës ose DKA nuk i ka ndaluar ose mohuar të drejtën e saj për shkollim, por nga drejtoria e shkollës së mesme “Kuvendi i Lezhës” u është tërhequr vërejtja me gojë, që atyre u ndalohej bartja në shkollë e shamive të zeza. Pas kësaj vërejtjeje, nxënësja e lartpërmendur ka lëshuar shkollën dhe drejtoria e shkollës nuk ka ndërmarrë masa disiplinore kundër saj dhe shpresoi se kjo ish nxënëse do të vazhdojë mësimin.
47. DKA më tej thekson se, “drejtoria e shkollës dhe DKA vetëm kanë zbatuar Rregulloren e Sjelljes dhe Disiplinës të Kuvendit Komunal të Vitisë Nr. 01-013/866, neni 22, para. 9, që përcakton se uniforma e studentëve duhet të jetë e njëjtë, dhe Udhëzimin Administrativ të MASHT-it Nr.7/2009, neni 4, para. 13, që përcakton se bartja e uniformave fetare nëpër shkolla është e ndaluar.
48. DKA në letrën e vet me shkrim thekson sërish se, “DKA nuk e ka mohuar në asnjë mënyrë të drejtën për shkollim të kësaj ish nxënëseje ... është trysni ndaj shkollës me qëllim të pengimit të procesit të arsimit dhe se qëllimi i saj ishte t’i imponohej DKA-së dhe shkollës një veshje e tillë, meqë nxënësit e feve të ndryshme, myslimanë e katolikë, ndjekin mësimet në këtë shkollë,... dhe se bartja në shkollë e shamisë së zezë është në kundërshtim me normat e aplikueshme dhe se do të hapte mundësinë e veshjes së uniformave dhe veshmbathjeve të ndryshme nga nxënësit e feve të ndryshme dhe se do të ishte një rrezik i madh i dëmtimit të marrëdhënieve ndërfetare në komunën tonë.”

Baza relevante ligjore

49. Një numër i dispozitave ligjore janë cituar nga ana e palëve në parashtrësas e tyre me shkrim.
50. Gjykata vëren se neni 6 i Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, i vitit 2002, specifikon se organizimi i programit arsimor në Kosovë përbëhet nga arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm. Kësisoj nivelet e arsimit janë organizuar si në vijim:
 - (a) *Niveli 0: Arsimi parashkollor (normalisht moshat 3 deri në 6 vjet);*
 - (b) *Niveli 1: Arsimi fillor (faza e parë e arsimit bazë) për 5 vjet (normalisht moshat 6 deri në 12 vjeç);*
 - (c) *Niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët (faza e dytë e arsimit bazë) për 4 vjet (normalisht moshat 12 deri në 15 vjeç); dhe*
 - (d) *Niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë për 3 ose 4 vjet, varësisht nga programet arsimore të përcaktuara nga MASHT (normalisht moshat 15 deri në 19 vjet).*
51. Neni 8 i po të njëjtit Ligj parashikon që, “*Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të ndjekin nivelin 3 (arsim i mesëm i lartë) mbi baza vullnetare*”.
52. Për më tepër, Kodi i Mirësjelljes dhe Masave Disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme të larta në nenin 3 përcakton obligimet e nxënësit, mes tjerash, “*Ta mbaj*

uniformën e shkollës gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale, nëse shkolla është përcaktuar që nxënësi të ketë uniformë“.

53. Neni 6 i po të njëjtit Kod përshkruan masat edukativo - disiplinore siç janë:

1. Vërejtje me gojë;
2. Vërejtje me shkrim;
3. Pezullim i përkohshëm nga garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet;
4. Pezullim i përkohshëm deri në 3 ditë;
5. Pezullim i përkohshëm deri në 1 muaj; dhe
6. Pezullim më shumë se 1 (një) muaj.

54. Më tej përcaktohet se vërejtja me gojë i shqiptohet nxënësit që ka bërë shkelje të lehtë të rregullave të shkollës.

55. Në fund, neni 4 i Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 7/2009, në pjesën relevante, thotë si në vijim:

“Nxënësit i ndalohet:

... ”

13. bartja e uniformës fetare.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

56. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.

57. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës i cili parasheh që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

58. Kushtet e pranueshmërisë janë të shtjelluara më tej në Ligj (shih p.sh. nenin 47 [2] i Ligjit) dhe në Rregulloren e punës.

59. Rregulli 36 i Rregullores së punës, në pjesën relevante, parashikon si në vijim:

“Rregulli 36

Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

- a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar, ose
- b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi, ose
- c) kërkesa është qartazi e bazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

- a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

- b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose
- c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose
- d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

Kriteret e pranueshmërisë për sa i përket mos-përmbarimit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut

60. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesja e kërkesës, në kërkesën e saj, ka theksuar se nuk ka mjet tjetër juridik që do të mund ta shfrytëzonte për të siguruar përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.
61. Gjykata e Qarkut në anën tjetër i referohet kushteve të pranueshmërisë së kërkesës, duke pohuar se parashtruesja e kërkesës duhet të shterë të gjitha mjetet e disponueshme, pra, të kërkojë përmbarimin e aktgjykimit në Gjykatën Komunale në Viti.
62. Gjykata Kushtetuese rikujton se Gjykata Komunale në Viti konfirmoi se parashtruesja e kërkesës kurrë nuk kishte paraqitur propozim për përmbarimin e Aktgjykimit CN. Nr. 24/09, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut.
63. Sa i përket kushtit për shterimin e mjeteve juridike, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore (shih p.sh. Aktgjykimi i Gjykatës në rastin nr. 06/10 Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë të 30 tetorit 2010) si në vijim:

50. Gjykata Kushtetuese rikujton që një kriter i ngjashëm për pranueshmëri është paraparë në nenin 35 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa").

51. Sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashtruesit e kërkesës duhet t'i shterin mjetet juridike vendëse që janë në dispozicion dhe efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut më tej pranoi që rregulli i shterjes nuk është as absolut as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike; me rastin e shqyrtimit nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të kihen parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë ndër të tjera se, ai duhet te ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin ligjor të vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës.

64. Gjykata Kushtetuese vëren se në kohën e shkeljes së pretenduar, Ligji për Kontestet Administrative i vitit 1977 (Gazeta Zyrtare Nr. 4/77 RSFJ) ishte i zbatueshëm. Kapitulli VI i ligjit, i quajtur “Dispozitat e Veçanta”, ka përcaktuar këtë masë ligjore dhe zbatimin e tij.
65. Gjykata Kushtetuese, po ashtu vëren se në kohën kur parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën dhe kur Gjykata ua komunikoi kërkesën palëve të tjera në procedurë, Ligji për Kontestet Administrative nuk ishte më i zbatueshëm. Në të vërtetë, më 16 shtator 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin e ri për Konfliktet Administrative.

66. Gjykata më tej vëren se procedura përmbartimore është e përcaktuar me Ligjin e Procedurës Përmbartimore të vitit 2008. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat gjyqësore të përmbartimit, përveç nëse është e përcaktuar ndryshe me ligj.
67. Sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës dhe dokumenteve në dosjen e rastit, është e qartë se parashtruesja e kërkesës kurrë nuk kishte paraqitur kërkesë për përmbartimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të datës 17 nëntor 2009.
68. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar “të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj” që është në kundërshtim me Rregullin 36.1(a) të Rregullores së punës.

Kriteret e pranueshmërisë për sa i përket ankesave të tjera të parashtrueses së kërkesës

69. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës ankohet se asaj i është mohuar e drejta për të vazhduar shkollimin. Sipas saj, pavarësisht se në Kosovë njihen të drejtat e saj për shkollim, që dy vjet asaj nuk i është lejuar të vijojë shkollën. Siç u theksua më herët, parashtruesja pohon se janë shkelur nenet e Kushtetutës si në vazhdim: neni 24 (Barazia para ligjit), neni 38 (Liria e Besimit, Ndërgjegjes dhe Fesë) dhe neni 47 (E drejta për shkollim). Në këtë kuptim, parashtruesja e kërkesës ka theksuar se “nenet e lartpërmendura janë shkelur, meqë asaj i është mohuar e drejta për të vazhduar shkollimin e saj në përputhje me aftësitë e saj sepse institucioni publik ia ka mohuar asaj të drejtën për të ndjekur procesin e mësimi përderisa ajo bart shaminë islame, ndonëse një akt të tillë Kushtetuta e quan diskriminim në baza fetare.”
70. Gjykata po ashtu rikujton, dhe kjo është e pakontestueshme ndërmjet palëve se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë vendim nga shkolla në të cilën vijonte mësimin (e as nga DKA), se asaj i është ndaluar vazhdimi i shkollimit apo se është përjashtuar nga shkolla.
71. Për më tepër, padia e parashtrueses së kërkesës është konfirmuar nga Gjykata e Qarkut me Aktgjykimin e 17 nëntorit 2009.
72. Rrjedhimisht, Gjykata nuk është e bindur me argumentin e parashtrueses së kërkesës se asaj i është ndaluar vijimi në shkollën “Kuvendi i Lezhës”. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, më 15 janar 2009 e ka ndërprerë vijimin e shkollimit në shkollën e saj në bazë të një “vërejtje gojore”. Vetëm pas tre muajsh, më 15 prill 2009, ajo iu drejtua një organi shtetëror relevant, DKA-së. Pas shtatë muajsh, parashtruesja e kërkesës ka pranuar një aktgjykim për të cilin ajo ankohet se nuk është përmbartuar.
73. Sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës dhe dokumenteve në dosjen e rastit, duket se parashtruesja e kërkesës fare nuk ka tentuar të vijojë shkollën pas datës 15 janar 2009.
74. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës “nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj” në kundërshtim me rregullin 36.1(d) të Rregullores së punës.
75. Për të njëjtat arsye, Gjykata është e mendimit se parashtruesja e kërkesës nuk e ka arsyetuar *prima facie* kërkesën e saj (shih rregullin 36 (2) a të cituar më lart). Në të vërtetë, faktet e rastit që janë paraqitur nga ana e parashtrueses së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese “në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese” në kundërshtim me rregullin 36.2 (b) dhe (c) të Rregullores së punës.

76. Në këtë drejtim, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës Gjykata është e obliguar që të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Gjykata Kushtetuese sjell ndër mend aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Dogru kundër Francës (Kërkesa Nr. 27058/05) e 4 dhjetorit 2008, si vijon:

“61. Gjykata përsërit se derisa liria fetare është kryesisht çështje e ndërgjegjes individuale, po ashtu nënkupton, ndërmjet tjerash, lirinë për manifestimin e fesë, vetëm dhe privatisht, ose në komunitet me të tjerët, në publik dhe në rrethin e atyre me të cilët e ndani besimin. Neni 9 radhit një numër të formave të cilat mund t'i merr manifestimi i fesë ose besimit, kryesisht lutja, mësimi, praktikimi dhe respektimi. Megjithatë, nuk mbron çdo akt të motivuar ose të inspiruar nga një fe ose besim dhe nuk garanton çdo herë të drejtën për t'u sjellë në mënyrën e rregulluar nga një besim fetar (shih Leyla Sahin, të cituar më lart, §§ 105 dhe 212).

62. Gjykata vëren tutje se në një shoqëri demokratike, në të cilën disa fe bashkëjetojnë brenda të njëjtës popullatë, mund të jetë e domosdoshme të kufizohet kjo liri me qëllim të pajtimit të interesave të grupeve të ndryshme dhe për të siguruar respektimin e besimeve të të gjithëve (shih Leyla Sahin, të cituar më lart, § 106). Shpeshherë është potencuar roli i Shtetit si një organizator neutral dhe i paanshëm i ushtrimit të feve dhe besimeve të ndryshme dhe është theksuar se ky rol është i favorshëm për rregullin publik, harmoninë dhe tolerancën fetare në një shoqëri demokratike. Po ashtu, konsideron që detyra e Shtetit për paanshmëri dhe paanësi nuk është në përputhje me secilën fuqi të Shtetit për të vlerësuar legjitimitetin e besimeve fetare dhe që kërkon nga Shteti të sigurojë tolerancën reciproke ndërmjet grupeve kundërshtuese (shih Leyla Sahin, të cituar më lart, § 107). Pluralizmi dhe demokracia mund të bazohen në dialog dhe në një frymë të kompromisit të domosdoshëm që kërkon koncesione të ndryshme nga individët që arsyetohen me qëllim të ruajtjes dhe promovimit të idealeve dhe vlerave të një shoqërie demokratike.

63. Në rastet kur ngrihen çështje për marrëdhënien ndërmjet Shtetit dhe feve, për të cilin opinionet në një shoqëri demokratike mund të jenë të ndryshme, duhet t'i jepet rëndësi të veçantë rolit të organit nacional për vendimmarrje. Posaçërisht, kjo do të vlejë kur kemi të bëjmë me rregullimin e bartjes së simboleve fetare në institucionet arsimore, për të cilin qëllim vendet në Evropë kanë marrë qasje të ndryshme. Rregullat në këtë fushë ndryshojnë nga një vend në tjetrin në bazë të traditave nacionale dhe kërkesave të imponuara nga nevoja për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe për ruajtjen e rendit publik (shih Leyla Sahin, të cituar më lart, §§ 108-09).

64. Po ashtu, Gjykata do të përsërisë që Shteti mund të kufizojë lirinë për manifestim të fesë, për shembull të veshjes së shamisë islame, nëse ushtrimi i asaj lirie është në kundërshtim me qëllimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, rendin publik dhe sigurinë publike (shih Leyla Sahin, të cituar më lart, § 111, dhe Refah Partisi (Partia e Mirëqenies) dhe të tjerët kundër Turqisë [GC], nos. 41340/98, 41342/98, 41343/98 and 41344/98, § 92, ECHR 2003-II). Detyrimi i një motoçiklisti, i cili ishte një Sikh që mbante turban, që të bartë helmetë si masë e sigurisë dhe çdo ndërhyrje tjetër që rezulton me ushtrimin e lirisë fetare të tij është arsyetuar në bazë të mbrojtjes së shëndetit (shih X kundër Britanisë së Madhe Nr. 7992/77, Vendimi i Komisionit më 12 korrik 1978, Vendimet dhe Raportet (DR) 14, p. 234). Po ashtu, kontrollet kufitare të detyrueshme në aeroporte (shih Phull kundër Francës (Vendimi.), nr. 35753/03, ECHR 2005-I, 11 janar 2005) ose në hyrje të konsullatës (shih El Morsli kundër

Francës (Vendimi), nr. 15585/06, 4 mars 2008, ECHR 2008-...) dhe urdhrat e heqjes së turbanit ose shamisë për t'iu nënshtruar kontrolleve të tilla, nuk përbëjnë ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës për liri fetare. Po ashtu, as rregullorja për veshjen e studentëve ose refuzimi i ofrimit të shërbimeve administrative, siç është lëshimi i diplomës, nuk përbëjnë ndërhyrje në rastet kur personi në fjalë nuk i zbaton rregullat (në rastin në fjalë është kërkuar nga një studente që barte shaminë islame që të del pa shami në fotografi për pasaportë), si një kërkesë e sistemit universitar laik (shih Karaduman kundër Turqisë, 16278/90, Vendimi i Komisionit i 3 majit 1993, DR 74, p. 93). Në rastin Dahlab (të cituar më sipër), Gjykata vendosi që ndalimi i veshjes së shamisë për një arsimtare gjatë dhënies së mësimi të fëmijëve të ri është “e domosdoshme në shoqëri demokratike”, duke marrë parasysh, ndërmjet të tjerash, faktin që laicizmi, që parasheh neutralitetin fetar në shkollë, është parim i paraparë në Kushtetutën e kantonit të Gjenevës. Gjykata potencoi “simbolet e fuqishme të jashtme” të përfaqësuar përmes bartjes së shamisë dhe efektin e konvertimit që mund të ketë duke imponuar në femra nga një rregull fetar që është vështirë të jetë në përputhje me parimin e barazisë gjinore.

65. Në rastet e Leyla Sahin dhe Köse e të Tjerët, Gjykata ka shqyrtuar ankesat e ngjashme me këtë rast dhe përfundoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 9, duke marrë parasysh, ndërmjet të tjerash, parimin e laicizmit.

66. Në rastin e Leyla Sahin, pas analizimit të kontekstit turk, Gjykata gjeti që Republika është themeluar mbi parimin që Shteti duhet të jetë laik, që ka marrë edhe vlera kushtetuese; që sistemi kushtetues i jep rëndësi primare mbrojtjes së të drejtave të femrave; që shumica e popullatës në vend janë myslimanë; dhe që për ata që kanë favorizuar laicizmin, shamia islamike është bërë simbol i islamit politik duke ushtruar një ndikim në rritje. Prandaj, ka përfunduar që laicizmi është pa dyshim një prej parimeve fundamentale të Shtetit dhe është në harmoni me sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Gjykata pra, vërejtë që laicizmi në Turqi ishte garantues i vlerave demokratike dhe parimi që liria e fesë është e pacenueshme dhe parimi që qytetarët janë të barabartë, dhe se po ashtu shërbente për të mbrojtur individët jo vetëm përballë ndërhyrjeve arbitrare nga shteti por edhe nga presionet e jashtme të lëvizjeve ekstremiste dhe që liria për manifestim të fesë, mund të kufizohet me qëllim të mbrojtjes së atyre vlerave. Gjykata konkludoi se ky nocion i laicizmit është në përputhje me vlerat e Konventës. Mbështetja e këtij sistemi duhet të merret si e domosdoshme për të mbrojtur sistemin demokratik në Turqi (shih Leyla Sahin, të cituar më sipër, § 114).

67. Në rastin e Köse dhe të tjerët (të cituar më sipër), Gjykata po ashtu mori parasysh që parimi i sekularizmit dhe neutralitetit në shkollë dhe respektimi i parimit të pluralizmit ishin të qarta dhe bazë tërësisht legjitime për të arsyetuar refuzimin e nxënësve që bartin shami të hyjnë në klasë pasi ata refuzuan, pavarësisht prej rregullave, heqjen e shamive islamike brenda objektit shkollor.

68. Gjatë aplikimit të këtyre parimeve dhe praktikës relevante gjyqësore për këtë rast, Gjykata vëren se autoritetet vendore kanë arsyetuar ndalimin e bartjes së shamisë gjatë klasave arsimore mbi bazën e përputhshmërisë me rregullat e shkollës për shëndetësi, siguri dhe përkujdesje, të cilat janë aplikuar për të gjithë nxënësit pa dallime. Po ashtu, Gjykata vëren se me refuzimin e heqjes së shamisë së saj, parashtruesja ka tejkaluar kufijtë rreth të drejtës së shprehjes dhe manifestimit të besimeve fetare në objektet shkollore.

69. Po ashtu, Gjykata vëren, në përgjithësi, se qëllimi i këtij kufizimi për manifestimin e besimit fetar është mbështetja e kërkesave për laicizëm në shkollë shtetërore, siç është interpretuar nga Conseil d'Etat në opinionin e dhënë më 27 nëntor 1989 dhe në praktikën gjyqësore të mëpastajme si dhe qarkore të ndryshme ministrore të lëshuara për këtë temë.

70. Më tutje, Gjykata vëren se sipas burimeve të ndryshme, bartja e shenjave fetare nuk është qenësisht në mospërputhje me parimin e laicizmit në shkollë, por është bërë ashtu në bazë të kushteve në të cilat janë bartur dhe pasojat që bartja e shenjës mund të shkaktojë.

71. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet një prej aktgjykimeve të mëhershme në të cilën është konstatuar se varet nga autoritetet nacionale, në ushtrimin e lirisë së veprimit, të kenë shumë kujdes për të siguruar që, gjatë respektimit të parimit për pluralizëm dhe liri të të tjerëve, manifestimi i lirisë fetare nga nxënësit në objekte shkollore të mos merr përmasa të një akti të dukshëm që do të përbën një burim të presionit dhe përjashtimit (shih Köse dhe të tjerët të cituar më lart). Në pikëpamjen e Gjykatës, ky shqetësim duket se është adresuar nga modeli laik i Francës.

72. Po ashtu, Gjykata vëren që në Francë, si dhe në Turqi dhe Zvicër, laicizmi është parim kushtetues dhe një parim themelues i Republikës, i respektuar nga e gjithë popullata dhe mbrojtja e të cilit është e rëndësishme primare, në veçanti në shkollë. Gjykata përsërit që një qëndrim që nuk respekton atë parim nuk do të pranohet domosdoshmërisht si mbulesë për lirinë e manifestimit të fesë dhe nuk do të gëzojë mbrojtjen nga neni 9 i Konventës (shih Refah Partisi (Partia e Prosperitetit) dhe të Tjerët të cituar më lart, § 93). Duke marrë parasysh lirinë e veprimit, e cila duhet t'u lihet shteteve anëtare sa i përket përcaktimit të marrëdhënieve ndërmjet Kishave dhe Shtetit, njohja dhe kufizimi i lirive fetare në bazë të kërkesave të laicizmit duket legjitime duke marrë parasysh vlerat bazë të Konventës.”

77. Gjykata rikujton që neni 8 i Kushtetutës e përcakton Republikën e Kosovës si një shtet laik dhe parasheh si vijon:

“Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.”

78. Rrjedhimisht, bazuar në të gjitha arsyet e lartpërmendura, kërkesa e parashtrueses duhet të shpallet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit, me shumicë votash

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme në bazë të rregullit 36 të Rregullores së Punës.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Dr. Iliriana Islami

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani